



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 117, datë 30.06.2021

MBI

**MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË SHOQËRISË ADMINISTRUESE “ALBSIG
INVEST” SH.A ME KËRKESAT E LIGJIT NR. 56/2020**

Në bazë të nenit 14, pika 4 dhe 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, pikës 3, të nenit 238, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe pikës 6, të nenit 57, të Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë administruese “Albsig Invest” sh.a me kërkesat e Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe rregulloreve në zbatim të tij.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE